



Datë: 21.05.2025

Numër Protokoli: 3394/2025

A.nr.327/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj– Demi anëtarë, më Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.327/2025, të datës 18.02.2025, të parashtruar nga ankuesja Sh.T, të cilin me autorizim e përfaqëson A.S, kundër organit të punësimit/Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, Nenin 16, paragrafi 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, me datë 21.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.327/2025, e datës 18.02.2025, e parashtruar nga ankuesja Sh.T.

A r s y e t i m

Ankuesja Sh.T (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 18.02.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos kompensimit të diferencës së pagës nga koeficienti 4.1 në atë 5.2 për periudhën nga data 01.02.2023 deri më datë 01.02.2024, kohë kur ka qenë në zëvendësim në pozitën Zyrtar për Arkiv.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.02.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (*tutje MASHTI*), ndërsa kjo e fundit më datë 08.04.2025 ka përcjellë fare përgjigje në ankesë.

Me tej Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me vendim me numër protokoli 2199/2025, të datës 02.04.2025, ka zgajtur afatin edhe për 10, ditë pune lidhur me ankesën e ankueses Sh.T.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 1070/2025 e datës 18.02.2025 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 13.02.2025, nga Sh.T, për A.S; emali i datës 17.01.2025, dërguar nga A.Sh, për A.S; Kërkesë me numër protokoli 2/2/001, e datës 08.01.2025, dërguar tek Udhëheqësja e

Divizionit për Burime Njerëzore e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë; Vendimi me numër protokolli Nr. 04/128, i datës 16.02.2023, i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Kopje e letërnjoftimit për Sh.T; Kërkesë e datës 22.02.2024, për Lejimin e pagesës retroaktive; Vendimi me numër protokolli 2-1989, i datës 04.11.2020, i nxjerr nga u.d Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Shkencës; Vendimi me numër protokolli 2-122, i datës 01.02.2024 nxjerr nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit; emali i datës 26.05.2024, dërguar nga Sh.T, për R.P; emali i datës 27.03, dërguar nga Sh.T, për A.Sh; emali i datës 24.11.2023, dërguar nga Sh.T, për T.S; emali i datës 25.04.2024, dërguar nga Sh.T, për R.P; Kërkesë për përgjigje në ankesë dërguar përmes emalit e datës 27.02.2025, dërguar nga R.K, për A.R; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 327/2025, e datës 08.04.2025; Akt Emërimi me numër protokolli 133/2024, i datës 06.11.2024; Akt Emërimi me numër protokolli 15/2024, i datës 05.09.2024; Emali i datës 17.01.2025, dërguar nga A.Sh, për A.S; Emaili i datës 01.04.2025, dërguar nga B.H, për N.R; Përshkrimi i Detyrave të punës për pozitën “ Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve Arkivore”; Lista e pagave për muajin janar deri në muajin dhjetor të vitit 2023; Lista e pagave për muajin janar të vitit 2024; Vendimi me numër protokolli 2199/2025, i datës 02.04.2025, i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses është e ***pabazuar***, sepse:

Nga shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesja sipas Akt Emërimit me Nr.15/2024 të datës 05.09.2024 është e punësuar në pozitën Receptoniste në MASHTI, dhe ankuesja sipas Akt Emërimit me Nr.133/2024 të datës 06.11.2024 është e punësuar në pozitën Zyrtare për Administrim e Dokumenteve Arkivore. Tutje u.d Sekretarja e Përgjithshme e MASHTI-së më datë 04.11.2020 ka nxjerr Vendim me numër 2-1898 me të cilin ankuesen e ka cekuar zyrtar zëvendësues i pozitës Zyrtar për Arkiv, të cilën pozitë e ka mbajtur si zëvendësues deri më datë 01.02.2024 ku sipas Vendimit me numër 2-122 të datës 01.02.2024 është caktuar ushtrues i detyrës së pozitës Zyrtar për Arkiv.

Ankuesja më datë 08.01.2025 përmes kërkesës me numër referencë 2/2-001 i është drejtuar Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në MASHTI, duke kërkuar kompensimin në mënyrë retroaktive të ekuivalencës së koeficientit nga 4.1 në 5.2 për periudhën kohore nga data 01.02.2023 deri më datë 01.02.2024, ndërsa Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në MASHTI, më datë 17.01.2025 përmes emalit ka njoftuar ankuesen se kanë bërë kërkesë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik përmes emalit të datës 27.11.2023 për t’u mundësuar ekuivalentim edhe për ju, por është refuzuar kërkesa jonë me arsyetimin se kompensimi retroaktiv vlen vetëm për rastet që kanë kaluar në procesin e korrigjimeve.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se mos kompensimin në mënyrë retroaktive ekuivalencës së koeficientit nga 4.1 në 5.2 për periudhën kohore nga data 01.02.2023 deri më datën 01.02.2024, për pozitën që ka qenë duke e ushtruar si zëvendësues është padrejtësi që është bërë në raport me mua, me tej ankuesja kërkon nga Këshilli, që ankesa të aprovohet, të anulohet përgjigja e datës 17.01.2025 e Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe të detyrohet MASHTI të paguaj këtë diferencë të mjeteve.

Kolegji i Këshillit, konstaton së caktimi i ankueses si zëvendësues e pozitës Zyrtar për Arkiv, sipas Vendimit me numër 2 është bërë bazuar në dispozitat e nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Paravera, mirëpo në këtë periudhë kohore kur është nxjerr ky vendim ka qenë i zbatueshëm Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, i cili në nenin 32 paragrafi 4, përcaktohej se një pozitë e rregullt pune në shërbimin civil mund të plotësohet

në rast të nevojës të zëvendësimit apo mungesës së përkohshme të një nëpunësi civil varësisht nga rasti, për një periudhë jo më të gjatë së 12 (dymbëdhjetë) muaj. Në këtë rast, procedurat e pranimit zhvillohen nga njësia e burimeve njerëzore, në pajtim me rregullat e përcaktuara me këtë ligj për nëpunësin administrativ dhe mbështetës, nga rrjedh se një pozitë e rregullt pune në shërbim civil, e mbetur e lirë për një periudhë deri 12 muaj, mund të plotësohet me zëvendësues, por që plotësimi i saj duhet të bëhet sipas dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se, zëvendësimi dhe plotësimi i një pozite në shërbim civil mund të bëhet përmes procedurës si vijon: **një pozitë profesionale** mund të zëvendësohet përkohësisht vetëm sipas procedurës së përcaktuar me nenin 32 paragrafi 4, apo procedurës së transferimit të përkohshëm, sipas nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik. Ndërsa plotësimi i pozitës profesionale të lirë bëhet në pajtim me rregullat ligjore lidhur me lëvizje brenda kategorisë së njëjtë e me pastaj përmes konkursit të hapur siç përcaktohet me nenin 34 dhe 38 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, ndërsa në rastin konkret kjo pozitë është mbajtur me zëvendësues për gati katër (4) vite.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses për kompensimin në mënyrë retroaktive ekuivalencës së koeficientit nga 4.1 në 5.2 për periudhën kohore nga data 01.02.2023 deri më datë 01.02.2024, Kolegji i Këshillit, vlerëson se sipas provave të lëndës, meqë pozita Zyrtar për Arkiv është mbajtur me zëvendësues nga data 04.11.2020, konsiston në faktin se kjo pozitë me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Qeveria e Republikës së Kosovës më datë 16.02.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. 04/128 për miratimin e ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve, duke e obliguar Thesarin e Kosovës dhe Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik që në vazhdimësi t'i korrigjojnë/përshtatin të dhënat e të punësuarve në sektorin publik sipas kërkesave të institucioneve, rrjedhimisht sipas shkresave të lëndës, gjegjësisht nga emali i datës 07.04.2024 të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore të MASHTI-it të dërguar për Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, konfirmohet fakti se koeficienti i pagës së Zyrtarit për Arkiv nga koeficienti i vjetër gjashtë (6) është ekuivalentuar në koeficientin e 4.1, ndërsa nga data 18.12.2023 është miratuar koeficienti 5.2, tutje sipas këtij emalit është kërkuar interpretim nga DMZP se a ju takon kompensimi retroaktiv që nga data 01.02.2023 edhe zyrtarëve të cilës me akt emërimi janë receptionist ndërsa më vendim ushtrojnë pozitën Zyrtar për Arkiv, mirëpo Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik përmes përfaqësuesit të tij më datë 07.03.2024 ka njoftuar Udhëheqësen e Divizionit të Burimeve Njerëzore të MASHTI-it, se kompensimi retroaktiv vlen për rastet që kanë kaluar në procesin e korrigjimeve e në pajtim me Vendimin me Nr. 04/128 e datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e kjo argumentohet me faktin se kur Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore të MASHTI-it përmes emalit të datës 22.12.2023 ka njoftuar Udhëheqësen e Divizionit për Teknologji Informativ dhe Shërbime Logjistike, se për ankuesin nuk kanë bërë ekuivalentim të koeficientit me arsyetim se në këtë pozitë është me vendim dhe nuk ka afat ligjor deri në përfundimin e kësaj detyre.

Marr për bazë konstatimin si më sipër dhe duke marr parasysh faktin e majtës së pozitës Zyrtar për Arkiv nga ankuesi, interpretimin të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik si njësi përgjegjëse për korrigjim sipas Vendimin me Nr. 04/128 e datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kolegji i Këshillit, mori për bazë si fakt relevante opinionin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave, të datë 31.03.2023, për të gjitha institucionet publike lidhur me efektet e ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me ç 'rast sipas pikës 4 të opinionit sqarohet se: *Punonjës të cilëve vet shtojca përkatëse e Ligjit, u është përcaktuar klasifikimi i posaçëm, p.sh: ekspertë sipas shtojcës së posaçme, specialistët, inspektorët, punonjësit në arsim, shëndetësi, art, kulture e trashëgimi kulturore apo një fushë tjetër ? (vijon korrigjimi edhe në ditët dhe javët në vazhdim-*

pagat u barazohen retroaktivisht nga momenti i hyrjes në fuqi të Ligjit), çka nënkupton fakti se pozitat e tjera nuk mund të përfitojë kompensim retroaktiv, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar.

Për sa me sipër, Kolegji i Këshillit bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.327/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit A.S;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MASHTI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.